



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.6503/2022

## SHËNIM PËR KËSHILLIM DHE VOTIM

(Neni 140 parag.1 i LPK-së)

Unanimisht është vendosur si në dispozitiv të këtij:

### A K T G J Y K I M

**LAPROVOHET PJESËRISHT** e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, **NDRYSHOHET PJESËRISHT** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.687/2021 të datës 23.06.2021 në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me kompensimin mbi bazën e kualifikimit dhe shpenzimeve të procedues për precizimin e kërkesëpadisë ashtu që lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, gjykohet si vijon:

**REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësve A..... S....., N....D....., A..... Sh..... – P..... dhe H..... B..... – P....., që për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 18.05.2018 në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit t’ia paguaj

- Paditëses A.... S..., për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri 18.06.2018, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 710.88 euro (*shpjegim:* paga bazë 421.00 euro x 27% i pagës bazë (113.00 euro - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68 euro ) x 13 muaj gjithsej 13 x 54.68 = **710.88 euro**),
- Paditësit N..... D....., për periudhën kohore, 18.04.2017 deri 18.06.2018, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 576.81 euro (

*shpjegim:* paga bazë 421.00€ x 27% i pagës bazë (113.00 euro - 68.13 diferencë e paguar në pagë = 44.87 euro ) x 13 muaj gjithsej 13x 44.37 = **576.81 euro**),

- Padiësës A..... Sh.....-P....., për periudhën kohore,18.04.2017 deri 18.06.2018, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 710.84 euro ( *shpjegim:* paga bazë 421.00 euro x 27% i pagës bazë ( 113.00€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68 euro ) x 13 muaj gjithsej 13 x 54.68 = **710.84 euro**),
- Padiësës H..... B....., për periudhën kohore,18.04.2017 deri 18.06.2018, t'ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 710.84 euro ( *shpjegim:* paga bazë 421.00 euro x 27% i pagës bazë ( 113.00 euro- 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68 euro ) x 13 muaj gjithsej 13 x 54.68 = **710.84 euro**), e në shumë e përgjithshme për të gjithë padiësit prej 2.709.45 euro, si dhe shpenzimet e procedurës për precizimin e kërkesëpadiës në shumë prej 520.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padiës nga data (08.06.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar** pjesa tjetër e ankesës së të padiës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahoves, Departamenti i përgjithshëm, C.nr.687/2021 i 23.06.2022 në pjesët tjera të vendosjes lidhur me pikën **I** dhe **II** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

III. Seanca e kolegjit është mbajtur me datë 17.04.2024.

**Anëtarët e kolegjit:**

Burim Shala \_\_\_\_\_

Naim Mehulli \_\_\_\_\_

**Kryetari i kolegjit:**

Ardian Ajvazi

\_\_\_\_\_